


Statistikat Tregtare të Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me SHBA

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkëmbimi tregtar me SHBA¹, në vitin 2025 deficitit tregtar ka shënuar një rritje prej 21.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke arritur në -81.8 milionë euro nga -67.1 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti sillet në rreth 23.0%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me SHBA sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	136.5	106.3	39.6	24.4
Import	71.9	86.3	106.7	106.3
Bilanci tregtar	64.6	20.1	(67.1)	(81.8)
% e mbulimit	189.8%	123.3%	37.1%	23.0%
Rritje Exp. (v-m-v) %	11.4%	-22.1%	-62.8%	-38.3%
Rritje Imp. (v-m-v) %	-22.6%	19.9%	23.7%	-0.4%
Bila. Treg. (v-m-v) %	117.6%	-68.9%	-434.7%	21.9%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


¹ Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të njohura edhe si Shtetet e Bashkuara (SHBA) ose Amerika, janë një vend i vendosur kryesisht në Amerikën e Veriut, me kryeqytet Uashington D.C. Ka një sipërfaqe prej 9,833,520 km² me rreth 341.8 milionë banorë. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) Nominal për 2025 vlerësohet rreth 30.8 trilionë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 89,991 \$ (dollar amerikan), e renditur ekonomia e parë më e madhe në botë nominalisht sipas FMN-së.

Analizuar në periudhën fundit katërvjeçare, nga viti 2022 deri në vitin 2025, bilanci tregtar i mallrave ndërmjet Kosovës dhe SHBA-së ka shënuar një përkeqësim të ndjeshëm, duke kaluar nga një suficit prej 64.6 milionë euro në vitin 2022 në një deficit prej 81.8 milionë euro në vitin 2025.

Kjo prirje është si rezultat i rënies së vazhdueshme të eksporteve kosovare drejt SHBA-së, nga 136.5 milionë euro sa ishte në vitin 2022 në 24.4 milionë euro në vitin 2025, ndërkohë që importet janë rritur dhe kanë mbetur në nivel të lartë,

Si rezultat i këtij trendi, norma e mbulimit të importeve me eksporte ka shënuar rënie nga 189.8% sa ishte në vitin 2022, në vetëm 23.0% në vitin 2025).

Figura 2. Eksport/Importi me SHBA sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)


Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara për në SHBA, shënoi rënie për 38.3% krahasuar me vitin paraprak, nga 39.6 milionë në 24.4 milionë euro, kjo paraqet rreth 2.6% si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm. SHBA renditet në grupin e top 10 vendeve kryesore të eksporti.

Importi i mallrave nga SHBA arritën në 106.3 milionë euro apo 1.5% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm.

Struktura e Eksportit/Importit me SHBA në 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Sipas të dhënave nga Open_DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesore të Eksportit e përbëjnë: 57.6% Tekstil dhe artikuj tekstili; 14.3% Artikuj të ndryshëm të prodhuara (kryesisht 99.7 % mobilieri, krevat, dyshek, mbajtës dyshekve, jastëk etj); 7.2% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 5.6% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 5.5% Mjetet e transportit; 3.3% Produkte bimore etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm me SHBA.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rënia e eksporteve për 38.3% apo rreth 15.2 milionë euro më pak mallra në tregun amerikan në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rënia te sektorët si, Artikuj të ndryshëm të prodhuara (mobiliari, krevat, dyshek, jastëk etj) (nga 49.4% në 14.3%) dhe te Metalet bazë dhe artikujt prej tyre (nga 9.1% në 5.6%) etj.

Eksportet e Kosovës drejt SHBA karakterizohen nga një përqendrim i lartë, ku vetëm dy sektorët kryesorë (artikuj tekstili dhe artikuj të ndryshëm si mobiliari, krevat, dyshek e jastëk) përbëjnë rreth 80.2% (v. 2024) dhe rreth 71.9% (v. 2025) të vlerës totale të eksportuar për vitet dy vitet e fundit. Vlen të theksohet se brenda një viti ka ndodhur një përmbyasje e strukturës së eksportit: derisa në vitin 2024 dominonin mobilierët dhe artikujt e ndryshëm me 49.4%, në vitin 2025 peshën kryesore e mori sektori i tekstit duke u rritur në 57.6% të eksportit total drejt SHBA-së.

Te Importet për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 21.4% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 19.1% Mjetet e transportit; 16.3% Produkte minerale; 10.4% Produkte të industrisë kimike; 9.4% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike; 8.4 % Instr. optike, mjeksore, fotografik muzikore etj.; 7.1% Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe; 4.5% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga SHBA.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës (DK)

Dominimi i plastikës, mjeteve të transportit, produkte kimike dhe produkteve minerale me 73.8% në 2024 dhe 67.2% në vitin 2025 në strukturën e importeve tregon varësinë e vazhdueshme të tregut dhe industrisë kosovare nga teknologjia dhe prodhimet industriale SHBA.

Këto lëvizje të shpejta (si të eksporti dhe të importi) në përqindjet e sektorëve brenda një viti, tregojnë për një paqëndrueshmëri të strukturës tregtare dhe një varësi të lartë nga kontrata specifike që mund të ndryshojnë bilancin vjetor.